

RAPORT

PËRMBLEDHËS I ECURISË

MILIEUKONTAKT SHQIPËRI

MILIEUKONTAKT
ALBANIA
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY



www.milieukontakt.org
office@milieukontakt.org

Përmbajtja:

Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive	3
Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile	4
Angazhimi ynë ndërkombëtar	5
Projektet e zhvilluara përgjatë viteve 2021-2022	7
A. Zhvillimi i Qëndrueshëm	7
B. Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh	10
C. Mjedisi dhe shëndeti	12
E. Politika dhe legjislacioni mjedisor	24
Shikueshmëria dhe media	27
Botime	30
Vizioni i së ardhmes	34
Transparenca dhe pasqyrat financiare	36

Mesazh nga Drejtuesja Ekzekutive

Valbona MAZREKU

Vitet që lamë pas kanë shënuar disa kriza globale që kanë patur ndikim të konsiderueshëm në mjedis dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve. Mjafton të përmendim Covid-19 dhe krizën e energjisë.

Pandemia COVID-19 ka rezultuar në efekte të shumta në mjedis dhe klimë. Reduktimi global i veprimtarisë moderne njerëzore siç është rënia e konsiderueshme e udhëtimeve të planifikuara ka çuar në një rënie të madhe të ndotjes së ajrit dhe ujit në shumë rajone. Në Kinë, bllokimet dhe masat e tjera rezultuan me 25% ulje të emetimeve të karbonit dhe 50% ulje të emetimeve të oksideve të azotit, për të cilat vlerësohet se mund të kenë shpëtuar të paktën 77,000 jetë gjatë dy muajve. Po ashtu dhë në vendin tonë u ndjen ndikimet e rënies së aktivitetit njerëzor gjatë pandemisë, duke rezultuar përgjatë monitorimit të ndotësve të ajrit në vlera nën standartin e OBSH-së (vetëm me dy javë mbyllje). Megjithatë, shkarkimet janë intensifikuar gjatë orarit aktiv, duke ritur në disa raste përqëndrimet e ndotjes edhe më shumë sesa përpara pandemisë.

Kriza e vazhdueshme energjetike ka goditur mjaft rëndë shumicën e vendeve në rajonin e Ballkanit, duke theksuar se modeli aktual i energjisë nuk është i qëndrueshëm teknikisht, ekonomikisht, dhe nuk është mjedisor apo social. Në shumicën e vendeve të rajonit prodhimi i energjisë bazohet në djegien e lëndëve djegëse fosile, ndërsa përzierja e energjisë së rinovueshme kryesisht (nëse jo ekskluzivisht) përbëhet nga biomasa tradicionale dhe hidrocentrale të mëdha.

Çmimet e energjisë janë rritur në qiell dhe mundësia për furnizim të mjaftueshëm me gaz "natyror", apo më mirë me gaz fosilesh për të përmbushur nevojat e shoqërive tona të varura prej tij bëhet përherë e më e paqartë. Kjo krizë energjetike, e kombinuar me atë klimatike, i lë miliona njerëz në mbarë botën pa mundësi për një burim të sigurt, të pastër dhe të qëndrueshëm të energjisë.

Puna e Milieukontakt synon shërbimin ndaj shoqërisë drejt qëndrueshmërisë. Ne kemi qenë të angazhuar veçanërisht në projekte të fushës së energjisë dhe demokratizimit të saj. Projektet tona, me ndihmë edhe të partnerëve ndërkombëtar kanë synuar krijimin e komuniteteve qytetare të energjisë, që të jenë të aftë të anagzhohen e bëhen pjesë në tranzicionin e energjisë që po ndodh, duke iu përshtatur tregut të energjisë dhe zhvilluar njëkohësisht kapacitetet në aspektin social dhe kulturor.

Shtylla tjetër e punës tonë ka qenë monitorimi alternativ i ajrit nga ndotës të ndryshëm, analizimin dhe advokimi për më shumë informacion, transparencë dhe pjesëmarrje në vendimmarrje që ndikon në cilësinë e ajrit.

Të gjitha projektet mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm janë një udhëtim me shumë kthesa. Ndaj organizatat e mjedisit duhet të qëndrojnë të përkushtuara dhe të mbështesin njëra-tjetrën. Me ndihmën e ndërsjellë mund të kapërcehet çdo pengesë! Nuk kemi kohë për të humbur.

Angazhimi ynë kombëtar përkrah shoqërisë civile

Së fundmi, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të bashkuara ka adoptuar një rezolutë historike ku ka deklaruar **të drejtën për një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm**, si një të drejtë themelore universale. Kjo rezolutë fton të gjithë qytetarët dhe institucionet të luftojnë për mbajtjen e premtimeve dhe angazhimeve. Vullneti politik dhe gatishmëria e qytetarëve për të kontribuar për çështjen janë faktorët kryesor, që mund të sjellin ndryshimin, sidomos atë të qëndrueshëm.

Në këtë kontekst Milieukontakt është pjesë e angazhimeve të ndryshme të OSHC-ve mjedisore kombëtare në mbrojtje të zonave të mbrojtura dhe ruajtje ato nga ndërhyrjet për investime infrastrukturore. Zonat e mbrojtura janë pasuri kombëtare dhe vendimmarrja për këto zona duhet t'i nënshtrohet kuadrit ligjor në fushën e planifikimit të territorit, ligjit për zonat e mbrojtura, ligjit për mbrojtjen e biodiversitetit, ligjin për mbrojtjen e mjedisit, si dhe ligjeve të tjera në fusha specifike. OSHC-të kanë konstatuar një anashkalim të dispozitave ligjore dhe një mungesë transparence në vendimmarrje. Për këtë arsye, beteja ligjore po vazhdon jo vetëm për mënyrën se si po zhvillohet procesi i këshillimit, por edhe të anës përmbajtësore të vendimeve dhe ndikimeve që kjo vendimmarrje do të ketë në sistemin e zonave të mbrojtura dhe larminë biologjike në Shqipëri.

Milieukontakt ka bashkuar forcat me organizatat mjedisore mbi vlerësimin mjedisor të zonës Patos & Roskovec që janë të ndikuar në mënyrë direkte nga industria nxjerrëse dhe problemet e shkaktuara prej saj.

Efektet e ndotjes nga nafta në zonën Patos-Marinëz, shtrihen në një zonë rreth 23000 ha. Pushteti vendor dhe komuniteti i ndikuar e kanë të nevojshme të informohen për problematikën dhe situatën mjedisore, si një e drejtë mjedisore që buron nga e drejta ndërkombëtare dhe kombëtare për një mjedis të shëndetshëm. Ndaj rrjeti i organizatave kanë kërkuar pranë institucioneve qendrore dhe atyre vendore të marrin masa të menjëhershme për monitorimin dhe rehabilitimin mjedisor në zonën e Patosit dhe Roskovecit.

Cilësia e ajrit urban, është kauza që Milieukontakt së bashku me 4 organizata vendore po punon për të adresuar problematikat që lidhen me cilësinë e ajrit, përmes aksesit dhe transparencës në informacion dhe avokimit për forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e ajrit. Rrjeti ka sjellë në vëmendje problemet shëndetësore të banorëve dhe privimin e së drejtës për të jetuar në një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm. Qytetarët nuk janë aspak të vetëdijshëm se si dalëngadalë po ekspozojnë çdo ditë e më shumë mushkритë e tyre ndaj sëmundjeve respirative që shpesh mund të jenë dhe të parikuperueshme.

“Kemi punuar dhe do të vazhdojmë të punojmë çdo ditë, që të jetojmë në një botë më të mirë se ajo që gjetëm. E dimë, kemi një rrugë të gjatë përpara si dhe shumë punë për të bërë. Por, ne jemi të angazhuar si dhe mirëpresim të gjithë vullnetarët, për t'u bërë pjesë e rrugëtimit tonë”.

Angazhimi ynë ndërkombëtar

Çështjet mjedisore, me problematikat dhe rrisqet e tyre janë çështje të cilat kërkojnë bashkëpunim dhe vëmendje jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Disa nga projektet e Milieukontakt kanë patur karakter rajonal me komponent mjaft të fortë bashkëpunimi dhe ndarje eksperiencash mes organizatave të ndryshme, duke ndërtuar dhe përfitur nga mësimet e nxëna.


Milieukontakt Shqipëri si partnere në projektin EmpowerMed (Horizon 2020) adreson së bashku me partnerët e tjerë (7 shtete) sfidën e varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë përfshirjen dhe fuqizimin e grave përgjatë fushatave të pilotimit dhe sidomos advokimit për të futur konceptin e varfërisë energjitike në kuadrin ligjor, por duke reflektuar sidomos elementët gjinor dhe ndikimin në shëndet.

Ndryshimet klimatike dhe pabarazia në botë në fushën e energjisë janë çështjet bazë që gjejnë përgjigje në platformën [EUCENA | EUCENA \(citizenenergy.academy\)](#) ku ju mund të mësoni mbi teknologjitë e energjive të rinovueshme që mundësojnë të prodhoni energjinë tuaj. Akademia nuk kufizohet vetëm në prodhimin e energjive të rinovueshme por thekson nevojën për pronësi komunitare. Komunitetet e energjisë janë zhvilluar për të decentralizuar fuqinë dhe janë krijuar mbi vlerat thelbësore të ndarjes dhe barazisë së pushtetit në të gjitha nivelet si dhe vetë iniciativës dhe vetë qeverisjes.

Leksionet tregojnë pjesët thelbësore për të promovuar barazinë në mënyrë që modeli i kooperativës energjitike të përfshijë njerëz të të gjitha niveleve, kombësive dhe gjinie. Milieukontakt është e angazhuar për të ndihmuar në ndarjen e informacionit, rritjen e njohurive dhe advokimin për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe mundësuar një mjedis për zhvillimin e komuniteteve të para të energjisë së rinovueshme.

Plastika, reduktimi i saj në paketimet e produkteve të ndryshme si dhe promovimi i praktikave të riciklimit apo ripërdorimit, si pjesë e strategjisë botërore për reduktimin e mbetjeve plastike, ka qenë pjesë e angazhimeve të Milieukontakt Shqipëri me partnerë ndërkombëtar. Aktivitete dhe studime janë përgatitura si pjesë e veprimeve të mëtejshme për trajtimin e mbetjeve plastike sipas Konventës së Bazelit për të promovuar parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike brenda politikave dhe strategjive kombëtare.

Milieukontakt është pjesë aktive e disa rrjeteve ndërkombëtare që operojnë në fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së lumenjve, pesticideve, barazisë gjinore, etj (si WMG, IHPN, GAIA, YEE) dhe së bashku me to ngre problematikat mjedisore që të jenë më mirë të pasqyruara në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe të detyrojnë qeveritë të jenë të përgjegjshme në angazhimet e tyre për një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.



Projektet e zhvilluara përgjatë viteve 2021-2022

A. Zhvillimi i Qëndrueshëm

Projekti është zbatuar nga Milieukontakt Shqipëri në bashkëpunim me AKZM-në dhe AdZM-në Fier, dhe ka synuar mbrojtjen e natyrës, ruajtjen dhe përmirësimin e degradimit të tokës në Parkun Kombëtar Divjak-Karavasta duke pastruar sipërfaqe të konsiderueshme nga mbetjet dhe bërë të mundur mbjelljen e pishave. Po ashtu në park janë vendosur koshat e nevojshëm si dhe nxitur e këshilluar turistët e komunitetin në zonë në përdorimin e çantave prej tekstili. Gjatë zbatimit të projektit nxënës nga shkollat përreth zonës janë informuar për ndryshimet klimatike, rëndësinë dhe ruajtjen e biodiversitetit në parkun e tyre.

Përfitimi kryesor nga rehabilitimi i dunave ranore me *Pinus halepensis*, *P. pinea*, *P. pinaster* në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta është rritja e qëndrueshmërisë së habitateve natyrore të dunave ndaj rreziqeve nga rritja e nivelit të detit, stuhitë dhe kushte të lidhura me ndryshimet klimatike, që mund të ndikojnë në kapacitetet natyrore për t'u përballuar me rreziqet si pasojë e ndryshimeve klimatike. Ndaj përzgjedhja e specieve rezistente ndaj klimës është vendimtare në suksesin e projekteve për ripyllëzim të qëndrueshëm.

prill - gusht 2021 "Pyllëzimi si zgjidhje natyrore për klimën dhe mbrojtjen e biodiversitetit në Parkun Kombëtar Divjakë - Karavasta"



- Pastrimi i parkut dhe mbjellja e pishave
- Minimizimi i mbetjeve plastike dhe atyre detare, nxitja e përdorimit të çantave prej tekstili
- Vendosja e koshave për hedhjen e mbeturinave nga turistët
- Informim të nxënësve për ndryshimet klimatike të shkollave në zonat përreth rëndësinë dhe ruajtjen e biodiversitetit në parkun kombëtar.

AKTORËT

Vendasit, turistët,
nxënës shkollash

PARTNERËT

AKZM, AdZm Fier

DONATORI

GEF/ SGP (Global
Environment Facility)

maj – dhjetor 2021

“Mirëmbajtja e shtigjeve në parkun Kombëtar Dajt dhe Divjakë-Karavasta”

Projekti ka adresuar zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në dy zonat e mbrojtura, duke ndihmuar, për menaxhimin dhe ruajtjen më të mirë të habitateve të tyre, përkatësisht përmirësimin e shtigjeve, për aktivitetet e ecjes dhe kontribuar për një qëndrueshmëri në terma afatgjatë. Përgjatë zhvillimit të projektit në qendër të vëmendjes ka qenë ruajtja e biodiversitetit, vlerave natyrore dhe kulturore në të dy zonat.

Si rezultat i rritjes së ndjeshme të numrit të vizitorëve dhe eksperiencës së krijuar ka qenë e domosdoshme që shtigjet duhet të jenë të hapura gjatë gjithë vitit dhe me infrastrukturën e duhur info-orientuese – gjë që është mundur nga projekti.

Z. Petrit Imeraj, ekspert mjedisi



Rezultatet:

- Prodhimi dhe montimi i katër tabelave drejtuese për shtigjet në PK Dajt
- Prodhimi dhe montimi i tre tabelave informuese për PK Dajt
- Prodhimi dhe montimi i një table informuese për qendrën informuese të PK Dajt
- Dy shkallare për lehtësimin e vizitorëve në shtigjet e PK Dajt
- Pastrimi dhe markimi i shtigjeve në PK Dajt
- Pastrimi i shkurreve, degëve dhe trungjeve të rënë përgjatë 25.5 km shtigje në PK Divjakë-Karavasta
- Prodhimi dhe montimi i një table informuese për qendrën informuese të PK Divjakë-Karavasta

AKTORËT

**Ekspert biodiversiteti
Ekspert për guidat natyrore**

PARTNERËT

AKZM, AdZm Fier, AdZm Tiranë

DONATORI

PNUD

dhjetor 2021 – gusht 2022

“Angazhimi i komunitetit ndaj qasjes së bazuar në ekosistem në Kune Vain, Lezhë”

Qasja e bazuar në ekosistem (EbA) në mjediset bregdetare po konsiderohet si një koncept i vlefshëm për të ndihmuar në adresimin e pasojave të ndryshimeve klimatike. Ai përfaqëson një sërë qasjesh adaptive të menaxhimit që përdorin biodiversitetin dhe habitatet natyrore si pjesë e një qasjeje të përgjithshme drejt ndihmës së biznesit dhe komuniteteve bregdetare që të përshtaten më mirë me efektet negative të ndryshimeve klimatike. Studimi përqendrohet në:

Kapacitetin teknik dhe institucional për adresimin e rreziqeve dhe ndryshimeve klimatike përmes EbA

Rezistencën ndaj klimës përmes demonstrimit të praktikave më të mira dhe ndërhyrjeve konkrete të EbA-as apo qasje të tjera, të përshtatshme për lagunën Kune Vain

Ndërgjegjësimin dhe pasurimin e njohurive mbi EbA-t efektive



Pas rehabilitimit të stacionit të hidrovorit në Tale, në fakt gjendja ka ndryshuar për mirë në lidhje me përmbytjet e tokave pasi uji i shiut largohet më shpejt nga sipërfaqet bujqësore.

L.Prela nga Barbullojë e Re në Lezhë.

- Hartimi i raportit studimor mbi performancën e ndërhyrjeve të EbA në komunitetet lokale në lagunën e Kune Vain

AKTORËT

Komuniteti i lagunës Kune-Vain
Ekspertë mjedisi

PARTNERËT

AdZm Lezhë

DONATORI


GIZ Shqipëri

B. Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh

maj 2021 – korrik 2022 "Përmirësimin i nivelit të grumbullimit të tarifës së menaxhimit të mbetjeve urbane, vlerësimi i nivelit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit"

Dëshiroj të falënderoj ofruesin e shërbimit që ishin katalizatorë në 'reaksionin tonë kimik', duke bashkuar aktorët dhe duke rritur kapacitetin tonë për të pasur një reagim të shpejtë me një rezultat shumë të mirë

Znj. Edisnaja Vuka, punonjëse e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore në Mirditë.



Bashki të Forta
28 janar 2022 · 🌐

Bashki të Forta ka zhvilluar workshop-in e rradhës me përfaqësuesit e bashkive të zonës së mbetjeve 🇲🇪 Shkodër-Lezhë.

Qëllimi i takimit ishte vlerësimi i nivelit të të ardhurave për çdo bashki nga tarifa për mbetjet për 2021 dhe standardizimit të Paketës Fiskale për mbledhjen dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore 🇲🇪.

Ky është wsh nr.3, që zhvillohet me 18 bashkitë partnere të projektit Bashki të Forta të qarqeve Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Fier për menaxhimin e mbe... Shiko më shumë

Rezultatet:

- Të 18 bashkitë kanë një regjistër të tatimpaguesve të biznesit.
 - Të 18 bashkitë kanë tarifën e pastrimit të vendosur veçmas nga tarifat e tjera vendore për vitin 2022.
 - 14 nga 18 bashki, njoftimi i detyrimit tatimor/tariforor bëhet përmes faturës analitike që i dërgohet tatimpaguesit familjar.
 - Të 18 bashkitë kanë procedura transparente për njoftimin e detyrimit ndaj tatimpaguesve të biznesit.
 - Të 18 bashkitë kanë paketë fiskale të standardizuar.
 - Në vitin 2021 arkëtimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit është 99,907,000 lekë më shumë se 2020
- Të 18 bashkitë kanë një regjistër të tatimpaguesve të biznesit.
 - Të 18 bashkitë kanë tarifën e pastrimit të vendosur veçmas nga tarifat e tjera vendore për vitin 2022.
 - 14 nga 18 bashki, njoftimi i detyrimit tatimor/tariforor bëhet përmes faturës analitike që i dërgohet tatimpaguesit familjar.
 - Të 18 bashkitë kanë procedura transparente për njoftimin e detyrimit ndaj tatimpaguesve të biznesit.
 - Të 18 bashkitë kanë paketë fiskale të standardizuar.
 - Në vitin 2021 arkëtimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit është 99,907,000 lekë më shumë se 2020.

AKTORËT

Specialistë nga sektori i shërbimeve publike; sektori i të ardhurave vendore dhe ekspert të fushës

PARTNERËT

18 bashki të qarkut Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Fier

DONATORI

Helvetas Albania, projekti i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

korrik 2020 – dhjetor 2021

“Parandalimi dhe reduktimi i mbetjeve plastike në Bashkinë Lezhë”

Projekt zbatuar nga Milieukontakt, me mbështetjen e GIZ dhe Bashkisë Lezhë për zbatimin e aktiviteteve pilot, nëpërmjet komunikimit, pjesëmarrjes dhe ndryshimit të sjelljes së qytetarëve, bizneseve, shkollave dhe aktorëve të tjerë për të parandaluar dhe reduktuar mbetjet plastike në Bashkinë Lezhë.

“Unë dhe stafi im kuptuam, se kërkohet një ndryshim fare i vogël në sjelljen tonë, nga i cili përfitojmë të gjithë, pra jo vetëm duke mos ju ofruar klientëve artikujt plastik me një përdorim, por edhe duke i inkurajuar e nxitur që të mos i përdorin ato, por t'i zëvendësojnë me artikuj miqësor me mjedisin”

Z. Ernest Jushi, bar-restorant “Trevi” Lezhë



Rezultatet:

- Projekte pilot të identifikuar, komunikimi dhe sigurimi i angazhimit të qytetarëve, bizneseve, shkollave dhe aktorëve të tjerë përkatës për parandalimin dhe reduktimin e mbetjeve plastike në Bashkinë Lezhë.
- Reduktimi i mbeturinave të hedhura në trupa ujor dhe venddepozitimet ilegale nga qytetarët dhe bizneset pranë kanalit të Cenit dhe reduktim i venddepozitimeve ilegale.
- Qytetarët e Lezhës raportojnë pranë qendrës së komunikimit, ankohen dhe kërkojnë informacion mbi cilësinë e menaxhimit të mbetjeve.
- 130 biznese përfshihen në iniciativën “Zonë me plastik të reduktuar”.
- Qytetarët përdorin kontenerët e veçantë për mbetjet plastike.
- 25 shkolla publike në bashkinë Lezhë përdorin setin me materiale edukuese gjatë orëve të hapura mësimore, për organizimin e konkursit dhe aktiviteteve të tjera demonstruese.
- Qytetarët dhe turistët të ndërgjegjshëm për përdorimin e koshave specifik për depozitimin e bishtave të cigareve, duke mos i hedhur në bregdet dhe në shëtitoret kryesore.

AKTORËT

**Bashkia Lezhë
Shkollat dhe nxënësit e qytetit
Bizneset në zonë, Komuniteti
Turistët**

PARTNERËT

Milieukontakt Shqipëri

DONATORI

GIZ Shqipëri

C. Mjedisi dhe shëndeti

Prill 2018 - 2021 “Mushkëri të gjelbra për qytetet tona”

Krijimi i një platforme alternative të monitorimit në mjedis mbi cilësinë e ajrit, nivelin e zhurmave dhe vlerësimin e shërbimeve në ekosistem nga gjelbërimi urban në qytetin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe Shkodrës. Projekti adreson në mënyrë indikative, por edhe sasiore ndotjen e ajrit, nivelin e zhurmave në zonat urbane si dhe reduktimin e gjelbërimit urban. Raportet e ndryshme evidentojnë dhe lidhin ngushtësisht këto tre komponent si kontribuesit kryesor, të cilët përcaktojnë cilësinë e jetës dhe shëndetin publik në qytetet tona.

“Ka shumë kriza globale, me të cilat duhet të përballemi. Shpresoj që kjo t’i bëjë njerëzit të mendojnë: po sikur të kishim këtë cilësi të mirë të ajrit, jo sepse të gjithë janë të detyruar të rrinë në shtëpi, por sepse ne menaxhojmë ndryshimin për të rregulluar transportin dhe energjinë.”

Znj. Aurora Dibra, Eksperte mjedisi



Rezultatet:

- Krijimi i një metodologjie monitorimi alternative të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse.
- Krijimi i një platforme Open-Source WEB & GIS nëpërmjet të cilës do të raportohen dhe publikohen të dhënat e gjeneruara nga monitorimi për 4 Bashkitë e përzgjedhura.
- Organizata dhe aktivistët aplikojnë në shkallë të gjerë metodologjinë e monitorimit alternativ, duke gjeneruar dhe ngarkuar të dhënat në platformën online.

AKTORËT

Shoqëria civile, institucione shtetërore, media, komuniteti

PARTNERËT

Milieukontakt Shqipëri, Co-Plan, Qendra EPER, Ekomjedisi, Qendra Aarhus Shkodër, Green Centre Shkodër, Klubi Ekologjik Elbasan

DONATORI

Bashkimi Evropian

tetor 2021 – nëntor 2022

“Monitorimi i ndotjes akustike në zonat bregdetare”

Qëllimi kryesor i projekti është fuqizimi i bashkëpunimit mes aktorëve lokal nëpërmjet përdorimit të instrumentave alternativ mbi monitorimin e zhurmave dhe më pas për të avokuar tek autoritetet vendore mbi mirëadministrimin e ndotjes akustike në Vlorë dhe Himarë. Zonat bregdetare janë zonat më të ekspozuara ndaj zhurmave, kryesisht përgjatë sezonit turistik; referuar Direktivës Evropiane mbi zhurmat standardi i lejuar gjatë ditës është 55 Db dhe gjatë natës 45 Db. Problematikat që hasen në lidhje me ndotjen akustike në të dyja bashkitë është pasojë e mungesës së planeve vendore të veprimit mbi zhurmën, mungesës së monitorimit të vazhdueshëm të niveleve të zhurmave, mungesës së kontrolleve të ushtruara si dhe transparencës nga institucionet përgjegjëse mbi veprimtaritë që gjenerojnë zhurma.

Rezultatet:

- Memorandum bashkëpunimi mes pushtetit vendor – shoqërisë civile dhe bizneseve në bashkitë Vlorë dhe Himarë
- Hartimi i një metodologjie dhe monitorimi alternativ të zhurmave në Bashkitë Vlorë dhe Himarë duke përfshirë edhe komunitetin.
- Evidentimi dhe dokumentimi i zonave më të ekspozuara ndaj zhurmave në bashkitë Vlorë dhe Himarë.
- Hartimi i 2 draft planeve të veprimit për miradministrimin e zhurmave në mjedis.
- Evidentimi i problematikës në media përmes shkrimeve dhe kronikave në TV dhe portalet lokale.

“Mund të jetë e lehtë të mendosh se zhurma nuk është një çështje serioze shëndetësore, në fund të fundit, është thjesht zhurmë. Nuk do të na vrasë... apo jo? Epo, ndoshta...”

Pavarësisht faktit që nuk mund ta shohim, ndotja akustike nuk duhet nënvlerësuar. Zhurma gjithënjë e në rritje për shkak të urbanizimit, ndikon në cilësinë e jetës së popullatës jo vetëm nëpërmjet ndërhyrjeve në aktivitetet normale njerëzore por duke dëmtuar shëndetin fiziologjik dhe psikologjik. Ndalni ndotjen akustike përpara se të ndalni së dëgjuari!”

Znj. Dorina Shehaj, Gjelbërimi 2000





AKTORËT


Bashkia Vlorë
Bashkia Himarë
Komunitetet e dy bashkive

PARTNERËT

Milieukontakt Shqipëri,
Instituti për Menaxhimin e
Mjedisit dhe Territorit,
Gjelbërimi 2000.

DONATORI

Lëviz Albania, Projekt i
Agjensisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim
(SDC)



prill – nëntor 2022

“Mjedis i pastër, shëndet dhe edukim cilësor në shkollat e Paskuqanit”

Projekti zbatohet në kuadër të programit ReLOaD2 dhe bashkëfinancohet nga Bashkia Kamëz. Përfituesit në këtë projekt janë Njësia Administrative Paskuqan, shkolla e mesme “Gramoz Palushi” dhe shkolla 9-vjeçare “Jashar Hoxha”. Aktivitetet e projektit janë zhvilluar pranë mjediseve të shkollave, në liqenin e Paskuqanit dhe zonat pranë bregut të lumit të Tiranës. Nëpërmjet tij synohet informimi, edukimi dhe angazhimi i nxënësve për rëndësinë e një mjedisi të pastër, që garanton një cilësi të mirë jete dhe brenda standardeve, duke bashkëpunuar me Nj.A Paskuqan dhe bashkinë Kamëz.

“Nisma të tilla ndihmojnë jo vetëm nxënësit por mësuesit e prindërit njëkohësisht. Në komunitetin e Paskuqanit ende ekzistojnë tabu, të cilat përjashtojnë përfshirjen dhe angazhimin e vajzave në aktivitete të ndryshme brenda shkollës dhe jashtë saj”.

Znj. Irena Pali, drejtor e shkollës 9-vjeçare “Jashar Hoxha”



Rezultatet:

- Informimi dhe ndërgjegjësimi dhe angazhimi i 600 nxënësve në dy shkollat e përfshira në projekt
- Pastrimi i dy zonave pilot në Nj.A. Paskuqan
- Pajisja e shkollave me kosha për ndarjen e mbeturinave (nga 5 kosha për çdo shkollë).
- Krijimi i grupit të ekologut në secilën prej shkollat e përfshira në projekt.
- Përmirësimi i pejzazhit pranë liqenit të Paskuqanit, duke bërë të mundur mbjelljen e 65 pemëve (lis dhe ah)

AKTORËT

**Komuniteti i Nj.A. Paskuqan
Shkollat në Nj.A Paskuqan**

PARTNERËT

**Bashkia Kamëz
Njësia Administrative Paskuqan**

DONATORI

**Programi Rajonal për Demokracinë
Vendore në Ballkanin Perëndimor 2
– ReLOaD2, financuar nga Bashkimi
Evropian (BE), zbatuar nga Programi
i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
(UNDP).**

maj 2022 – qershor 2023

“Ajër i pastër, jetë e shëndetshme”

Ndotja e ajrit në vendin tonë është një problematik të cilës i duhet dhënë vëmendja e duhur nga institucionet përgjegjëse dhe të merren masa emergjente. Pikërisht këtë synon edhe projekti “Ajër i pastër, jetë e shëndetshme”, duke krijuar rrjetin kombëtar të OJF-ve, i cili do të adresojë problematikat që lidhen me cilësinë e ajrit, përmes monitorimit alternativ, analizimit dhe advokimit, si dhe për të vleftësuar të drejtën për informacion mbi procesin e vendimmarrjes që ndikon në cilësinë e ajrit.

“I pyesim pacientët në lidhje me ambientin në të cilin jetojnë gjatë marrjes së anamnezës së jetës, si dhe u flasim pacientëve për ndikimin e ajrit të ndotur në shëndetin e tyre”.

Mjek familje



Rezultatet:

- Rrjeti i OJF-ve marrin pjesë dhe kontribuojnë në përmirësimin e kuadrit rregullator në nivel vendor dhe kombëtar për një cilësi më të mirë ajri dhe brenda standarteve të vendosura nga legjislacioni në fuqi.
- Rrjeti funksional i OJF-ve mjedisore mbi cilësinë e ajrit aktiv dhe pas mbarimit të projektit.
- Përditësim njohurish e informacioni për grupe të ekspertëve, politikbërësve, vendimmarrësve, mediave, OJF-ve dhe qytetarëve, në fusha të ndryshme multidisiplinare (industri, transport, shëndetësi) lidhur me cilësinë e ajrit.
- 1000 stacione monitorimi alternativ për 4 parametra (PM2.5, PM10, CO2, NO2) të cilësisë së ajrit në 5 qytete kryesore dhe përditësimi i platformës www.greenlungs.al.

AKTORËT

Tiranë
Korçë
Elbasan
Durrës
Shkodër

PARTNERËT

EPER center
Together for Life
GO2

DONATORI

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze, i zbatuar nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me CISP Sviluppo dei Popoli, VIS Albania dhe COSV – Cooperazione per lo Sviluppo”.

shtator 2019 – gusht 2023

“Fuqizimi i grave për të marrë veprime kundër varfërisë energjitike në Mesdhe (Horizon 2020)”

Projekti punon për adresimin e sfidave të varfërisë energjitike në zonën e Mesdheut, me fokus të veçantë në përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Në vendet e mesdheut, zonat bregdetare hasin një sërë sfidash në lidhje me varfërinë energjitike; ky fenomen haset gjithashtu edhe në banesa. Ndërtesat rrallë janë të izoluar, shpesh pa sistem ngrohje, ose jo efikas. Një element tjetër i varfërisë energjitike në këto zona lidhet edhe me ftohjen e banesave. Në përgjithësi është vërejtur se varfëria e energjitike prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe familjet e drejtuara nga gratë, të cilat janë aktori më i rëndësishëm në luftën kundër varfërisë së energjisë. Projekti do të trajtojë specifikisht edhe ndikimin e varfërisë energjitike në shëndetin e njeriut. Ai do të kontribuojë në reduktimin e varfërisë energjitike në Mesdhe (përfshirë këtu edhe Shqipërinë) duke zbatuar një seri masash praktike për efikasitetin e energjisë dhe përdorimin e BRE me qëllim forcimin e familjeve në adresimin e varfërisë energjetike (në fokus gratë dhe shëndetin). Do të vlerësohen gjithashtu dhe masat e rekomandimet që mund të zbatohen në nivel politik, duke advokuar dhe adresuar politikat dhe masat për varfërinë energjitike tek aktorët në nivel lokal dhe në nivel Evropian.

Znj. Entela Murataj, audituese energjie



Në zonat rurale përballimi i jetesës është në nivele jo të kënaqshme, kjo vjen si pasojë e një ekonomie të dobët, të ardhurat e ulëta për shumë familje sjellin vështirësi në shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, sic është fatura e energjisë elektrike. Në familjet me kryefamiljare gra kriza thellohet akoma më shumë, pasi ende burri mbetet burimi i të ardhurave, gruaja ngelet pa “çati” mbi kokë në momentin e ndryshimit të statusit të saj. Mbështetja në logjistikë dhe informimi i vazhdueshëm do të bëjë të mundur zbutjen e këtij mentaliteti dhe t’i japi mundësi gruas të luftoj dhe të kërkoj hapësira për të siguruar të ardhura edhe pa mbështetjen e bashkëshortit.

Rezultatet:

- Krijimi i rrjetit me aktorët lokal në zonën e Mesdheut (Vlorë – Shqipëri, Barcelonë – Spanjë, Marseille – Francë, Padova – Itali, Primorska – Slloveni, dhe Zadar – Kroaci) duke kaluar njohuritë e eksperiencave thelbësore për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në zbatimin e masave praktike.
- Masa praktike, për të adresuar varfërinë energjitike (qasje në komunitet, vizita në banesa, mbështetje me investime të vogla, ëorkshop për 60 individë nga personeli mjeksor në Bashkinë Vlorë.
- Analizë mbi aktivitetet e zbatuara, ku rezultatet e përfutuara do të jenë baza e rekomandimeve politike që do të hartohen. Partnerët e projektit dhe aktorët vendor do të advokojnë për promovimin e politikave që adresojnë varfërinë energjitike.

AKTORËT

Bashkia Vlorë Familje të prekura nga varfëria energjitike
Gratë kryefamiljare të prekura nga varfëria energjitike
Familje me probleme shëndetësore.

PARTNERËT

Milieukontakt Shqipëri,
DOOR, SOGESCA, UAB, IREC, GERES,
WEFC, ESF koordinuar nga Focus.

DONATORI

Komisioni Evropian,
Programi Horizon 2020

tetor 2020 – shtator 2022 EUCENA

“Akademia e Energjisë për Qytetarët e Europës”

“Akademia e energjisë për qytetarët e Europës” ka për qëllim diversifikimin e lëvizjes së qytetarëve për energjinë në Evropë, duke u fokusuar në krijimin dhe transferimin e njohurive ndërmjet Evropës qendrore dhe asaj juglindore. Akademia do të ofrojë njohuri dhe mjete për ndërtimin e komuniteteve, zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre. Praktikant më të mira do të tregojnë si mund t'i tejkalojnë barrierat për energjinë e qytetarëve.

#PiskovaSolarFarming Fushata e mbledhjes së fondeve së bashku me partnerin tonë Electra Energy Cooperative për të mbështetur një nga komunitetet e para solare në Shqipëri! Instalimi i 8 kw panele fotovoltaike do të ndihmojë të ulen kostot e ujitjes për fermerët e zonës së #Përmetit. Fshati #Piskovë. Ky investim do të kursejë 5.9 ton CO2 dhe 780 euro kursim cdo vit. Per me shume info linku i fushatës <https://chuffed.org/project/lets-solarize-albania>



Janë këta të rinjë, të cilët me anë të kapaciteteve personale dhe njohurive të fituara dita-ditës, do të synojnë për gjetjen e mundësive financiare dhe kapaciteteve njerëzore për përdorimin e paneleve diellore dhe atyre fotovoltaike në banesa, institucione apo organizmat ku ata mund të kontribuojnë në të ardhmen e afërt.

Z. Arion Sauku, menaxher projekti

Rezultatet:

- Workshop dhe sesione trainimi në Shqipëri, Greqi dhe Gjermani.
- Ngritjen e kapaciteteve në vendet e Evropës juglindore, duke ofruar njëkohësisht edhe eksperiencat për çdo vend.
- Dy shkollat verore, do të rrisin bashkëpunimin ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore ku komunitetet e energjisë sapo kanë nisur dhe, Evropës Qendrore që tashmë ka një traditë të këtyre komuniteteve, duke diversifikuar kështu komunitetet e energjisë ndërmjet shteteve.
- Qasje gjithëpërfshirëse, duke angazhuar qytetarët e moshave, gjinive, niveli socio-ekonomik dhe grupeve etnike të ndryshme; për të tejkaluar varfërinë dhe mobilitetin energjistik dhe pabarazinë gjinore.

AKTORËT

Shoqëria civile,
komuniteti

PARTNERËT

REScoop.eu
Women Engage for a Common Future e.V. (WECF)
Bündnis Bürgerenergie e.V.
ELECTRA Energy – Social Cooperative
Milieukontakt Shqipëri

DONATORI

Ministria Federale e Cështjeve
ekonomike dhe veprimeve për
klimën në Gjermani, zbatuar nga
programi EUKI

shtator 2020 – gusht 2022

“WatSanPlan”

Projekti po zhvillohet në Rumani, Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Serbi, ku ka mungesa për sigurinë e ujit dhe menaxhimin e higjienës në zonat rurale, situatë që mund të shkaktojë pasoja serioze për mjedisin dhe shëndetin e popullatës. Qëllimi ynë është të përshtasim e të zhvillojmë më tej instrumentin e Ujit dhe Planifikimin e Sigurt të Higjienës (WSSP) në vendet e synuara. Projekti zhvillon metoda për analizën e rrishtit dhe vlerësimin e ujit e higjienës, duke treguar masat që mund të merren për të minimizuar rrishtin dhe përmirësuar situatën.

“Uji ende mbetet një sfidë për vendet e Ballkanit, për aq kohë sa ende filtret për cilësi jo të mirë të ujërave, qasje të kufizuara të përdoruesve dhe menaxhim jo i përshtatshëm institucional dhe komunitar. Misioni ynë vazhdon, në përmirësimin e detyrave si qytetar dhe detyrimin institucional, për të përmirësuar një prej të drejtave themelore të çdo qytetari siç është “uji” dhe kontribuar për dhe drejt zhvillimit të qëndrueshëm në nivel rajonal.

Znj. Bistra Mihaylova, Kordinatore politikash rajonale për vendet e Ballkanit dhe Azerbajxhanin

Rezultatet:

- Kualifikimi / trajnimi i 20 mësuesëve
- Kualifikimi / trajnimi i 30 nxënësve
- Teste të cilësisë së ujit në Tiranë dhe Lezhë, duke publikuar më pas rezultatet në një hartë të përbashkët me partnerët e projektit.
- Fushatë informuese dhe përfshirje të qytetarëve
- Promovim dhe angazhim të nxënësve të shkollave 9-vjeçare në ditë mjedisore, të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aksesin dhe cilësinë e ujit.



AKTORËT

Komuniteti pranë qytetit të Tiranës dhe Lezhës, Institucionet e arsimit mësuesit, nxënësit

PARTNERËT

WECF, Women in Development, Milieukontakt Albania, Acuademica, Journalist for Human Rights, Environmental Ambassadors for Sustainable Development

DONATORI





Ministria Federale e Cështjeve ekonomike dhe veprimeve për Klimën në Gjermani

shtator 2021 - qershor 2022

“SGP për mbetjet plastike”

Projekti synon të kryejë vlerësimin fillestar dhe të ofrojë mbështetje për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe institucional për të siguruar menaxhim të qëndrueshëm mjedisor të mbetjeve plastike, si dhe të përcaktojë dhe planifikojë masat e duhura për të promovuar parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike brenda politikave dhe strategjive kombëtare.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të sasive në rritje të vazhdueshme të mbetjeve plastike.

-  **Analizë që përshkruan statusin e menaxhimit të mbetjeve me fokus të veçantë në mbetjet plastike**
-  **Raportoni me burimet dhe sasitë e identifikuara të mbetjeve plastike dhe rritjen e menaxhimit të të dhënave përmes testimit të paketës së inventarit të mbetjeve plastike BC**
-  **Dokument vlerësimi ku vlerësohet kuadri ligjor dhe institucional kombëtar dhe propozohen rekomandime për të siguruar ESM-në e mbetjeve plastike**
-  **Promovimi i temës dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave në nivel rajonal.**

AKTORËT

Publiku i gjerë,
institucionet
shtetërore

PARTNERËT

Shqipëria
Bjellorusia
Bosnia dhe Herzegovina
Gjeorgjia
Moldavia
Maqedonia e Veriut

DONATORI

BCRC Slovakia


korrik 2021 – maj 2022 Circula Mare

Për të luftuar ndikimet negative të sasive në rritje drastike të mbetjeve plastike, Aleanca për t'i dhënë fund Mbetjeve Plastike, mbështeti Milieukontakt Shqipëri të realizojë një studim vlerësimi të detajuar të flukseve të materialeve të mbetjeve plastike dhe praktikave dhe tendencave ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve plastike në Shqipëri në tre bashki: Tiranë, Lezhë dhe Shkodër. Kjo do të ndihmojë për të kuptuar më mirë dhe për të identifikuar boshllëqet dhe barrierat për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve plastike dhe fushat e mundshme të ndërhyrjes. Përveç tre bashkive të përmendura, Porti i Durrësit është përfshirë në studim për vlerësimin e mbeturinave detare, duke përfshirë pajisjet e peshkimit të humbura dhe të hedhura (ALDGF).

Që nga fillimi i tij në janar 2019, Aleanca ka mbledhur mbi 80 kompani anëtare, partnerë të projektit, dhe mbështetës të angazhuar për t'i dhënë fund mbetjeve plastike në mjedis në mbarë botën. Në Rajonin e Mesdheut, Aleanca ka bashkuar forcat me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH për të mbështetur reduktimin e mbetjeve plastike që hyjnë në mjedis në nëntë vende: Shqipëri, Algjeri, Egjipt, Greqi, Kosovë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Turqia.

Rezultatet:

- Realizimi i një studimi vlerësimi bazë, duke përfshirë kuantifikimin dhe karakterizimin e mbetjeve me fokus të veçantë në polimerët plastikë për tre bashki.
- Realizimi i një analize të thelluar të sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve
- Formulimi i rekomandimeve përkatëse si për pushtetin vendor edhe për biznesin e komunitetin.



AKTORËT

**Bashkitë Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Durrës.
Kompani pastrimi dhe riciklimi të shtrira në këto bashki.**

PARTNERËT

GIZ Internacional

DONATORI


**Aleanca për t'i dhënë fund
Mbetjeve Plastike**

qershor – dhjetor 2021

“Premtimet elektorale për mjedisin përgjatë zgjedhjeve të 25 prillit, 2021”

D. Politika dhe legjislacioni mjedisor

Identifikimi, mbledhja dhe publikimi on-line i premtimeve elektorale për mjedisin, të legjislaturës 2021-2025 përkrah atyre të bëra përgjatë legjislaturës 2017-2021, projekt i mbështetur nga Fondacioni për Demokraci Westminster, përgjatë të cilit është bërë e mundur mbledhja e të gjitha premtimeve të bëra nga Legjislatura. Janë hulumtuar platformat dhe përdorur komunikimet zyrtare me partitë politike, mediat, takimet me organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë punuar me premtimet e bëra për mjedisin nga kandidatët fitues të zgjedhjeve të 25 prillit. Të gjitha premtimet e mbledhura janë paraqitur në një regjistër elektronik, i cili mund të arrihet lehtësisht duke përdorur adresën: <http://milieukontakt.org/regjistri-i-premtimeve-elektorale/> ku të gjithë aktorët e interesuar mund të shohin premtimet e bëra për mjedisin, nga një forcë e caktuar politike, kohën dhe vendin që është bërë premtimi, ku nga ekipi ynë bëhet një vlerësim i vazhduar nëse premtimet e bëra për mjedisin janë përmbushur përgjatë Legjislaturës 2021-2025.



Rezultatet:

- Një regjistër elektronik, në shërbim të të gjithë aktorëve të interesuar për premtimet e bëra për fushën e mjedisit përgjatë Legjislaturës 2017-2021 dhe 2021-2025.



AKTORËT

Shoqëria civile

PARTNERËT

Përfaqësitë e partive të Legjislaturës 2021-2025

DONATORI

Fondacioni Westminster për Demokraci, WFD

korrik 2021 – shtator 2022

“Prokurimi publik i gjelbër”

Projekti zbatohet si pjesë e Programit të Granteve të Vogla (SGP) për Mbetjet Plastike, i projektit "Veprime të mëtejshme për trajtimin e mbetjeve plastike sipas Konventës së Bazelit".

Strategjia Evropiane për Plastikën, lidhur me rritjen e vazhdueshme të prodhimit të mbetjeve plastike dhe depozitimin e tyre në mjedis, veçanërisht në mjedisin detar, thekson se vendet duhet urgjentisht të trajtojnë këtë çështje për të kryer një cikël jetësor që përfshihet plotësisht me nevojën për të zhvilluar praktikën e ripërdorimit dhe riciklimit duke zëvendësuar plastikën me materiale inovative. Aktualisht, qeveria shqiptare ka miratuar një ndryshim në Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve për qeset plastike njëpërdorimshe (deri në ndalimin e plotë të qeseve plastike); ka nisur Fushatën e Komunikimit të Planit Kombëtar për Pastrim dhe Riciklim.

Kjo dokument politik mbi prokurimin dhe kufizimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimshe synon të ofrojë një kuptim të përbashkët të grupit të masave dhe kritereve mjedisore që mund të merren parasysh në trajtimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimshe në prokurimet publike në Bashkinë Krujë. Zakonisht, kriteret ekonomike janë fokusi kryesor i strategjive të prokurimit. Megjithatë, me një kërkesë në rritje politike dhe publike për zbatimin e zhvillimit e qëndrueshëm, kriteret tjerë nga ato thjesht ekonomike po shqyrtohen edhe në ligjin shqiptar të prokurimeve publike; kriteret që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Për më shumë mund të shihet një video e shkurtër (45) Prokurimi publik i gjelbër - YouTube



Rezultatet:

- Zbatimi pilot i kritereve specifike të prokurimit publik me fokus parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike në Shqipëri.

AKTORËT

Ekspertë të fushës,
punonjës të bashkisë.

PARTNERËT

Bashkia Krujë
Agjencia e Mjedisit Sllovaki

DONATORI

Agjencia Norvegjeze për Bashkëpunimin për Zhvillim (Norad).

korrik 2021 – maj 2022

"Buxhetimi i gjelbër"

Vlerësimi i buxhetit sesa i gjelbër është ai, përbën një hap të rëndësishëm për promovimin e ecurisë drejt përbushjes së objektivave mjedisore. BE e përkufizon buxhetimin e gjelbër si 'proces buxhetimi ku kontributi në mjedis i zërave buxhetorë identifikohet dhe vlerësohet në lidhje me tregues specifikë performance, duke synuar përafrimin më të mirë të politikave buxhetore me ato mjedisore. Kjo përfshin vlerësim të ndikimit në mjedis të politikave fiskale ose buxhetore dhe vlerësim të koherencës në përbushje të angazhimeve kombëtare dhe globale. Buxhetimi i gjelbër kontribuon në debate të bazuara në evidenca dhe informacione, dhe diskutime mbi rritjen e qëndrueshme".

Rezultatet:

- Përgatitja e një metodologjie cilësore të shëndoshë për përgatitjen e Raportit të Vlerësimi.


Përgatitja e një raporti vlerësimi të hollësishëm duke analizuar dhe shqyrtuar kuadrin legjislativ dhe dokumentet strategjike të miratuara nga Qeveria dhe Parlamenti.

- Dorëzimi zyrtar i raportit komisionit parlamentar përkatës dhe institucioneve të tjera.
- Organizimi i një seminari mbi buxhetin e gjelbër për të ndarë dhe komunikuar gjetjet dhe rekomandimet e raportit me deputetët, vendimmarrësit, OSHC-të mjedisore, mediat dhe aktorë të tjerë të interesuar.

- Publikimi dhe shpërndarja e raportit të vlerësimi ose e gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore në platforma të ndryshme të komunikimit mediatic.

Buxhetimi i gjelbër është një koncept i ri jo vetëm për Shqipërinë por edhe për vende të tjera të zhvilluara. Ai është një formë e buxhetit prioritar, sikundër politika të reja shfaqen për politikëbërësit edhe qeveritë vendosin qasje buxhetore novatore për të ndihmuar arritjen e këtyre objektivave, si psh buxhetimi gjinor, i gjelbër dhe i mirëqenies. Pak vende kanë praktika të buxhetimit të gjelbër dhe ato janë tepër heterogjene.

Ky studim merr në shqyrtim kuadrin specifik kombëtar për të konfirmuar përputhshmërinë dhe koherencën me buxhetimin e gjelbër dhe angazhimet globale të lidhura me veprimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe vlerësimin e mjeteve ekzistuese për të kryer buxhetimin e gjelbër në Shqipëri.



AKTORËT

Eksptër të fushës,
OJF Mjedisore

PARTNERËT

Studio D, Deputetë të forcave të ndryshme politike.

DONATORI

Fondacioni Westminster për
Demokraci, WFD

A background image showing two hands holding several interlocking puzzle pieces. The puzzle pieces are light purple and white, and the hands are light-skinned. The background is a soft, light greenish-yellow gradient.

DONATORËT TANË

Delegacioni i Bashkimit Evropian, GEF/SGP, GIZ Shqipëri, HELVETAS Swiss Intercooperation – Programi Bashki të forta, Komisioni Evropian – Programi Horizon 2020, Lëviz Albania, Ministria Federale e Çështjeve Ekonomike dhe veprimeve për Klimën në Gjermani, Qeveria Gjermane, Qeveria Zvicerane, UNDP Shqipëri, Fondacioni Westminster për Demokraci - WFD, Agjencia Norvegjeze për Bashkëpunimin për Zhvillim, BCRC Slovakia, Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2,

A background image showing two hands shaking in a firm grip. The hands are light blue and white, and the background is a light blue gradient.

PARTNERËT TANË

Acuademica, Bündnis Bürgerenergie, Bashkia Tiranë, Bashkia Kamëz, Bashkia Lezhë, Bashkia Krujë, Bashkia Shkodër, Co-Plan, CISP Sviluppo dei Popoli, COSV – Cooperazione per lo Sviluppo, DOOR, ELECTRA Energy – Social Cooperative, ESF, Qendra EPER, Environmental Ambassadors for Sustainable Development, Focus, GO2, GERES, Gjelbërimi 2000, Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit, IREC, Jouranlist for Human Rights, Klubi Ekologjik Elbasan, Qendra Aarhus Shkodër, REScoop.eu asbl, SOGESCA, Together for Life, VIS Albania, UAB, Women Engage for a Common Future (WECF), Woman in Development (WiD).

SHIKUESHMËRIA DHE MEDIA

Përgjatë punës së përditshme kemi dokumentuar dhe bërë të dukshëm aktivitetet dhe nismat tona, nëpërmjet të cilave rezultatet, gjetje dhe fakte të ndryshme janë ndarë me mediat e televizioneve, radiove, median e shkruar dhe atë sociale.

“Nganjëherë fjalët nuk mjaftojnë.
Atëherë nevojiten ngjyrat, format, tingujt dhe emocionet”.

Alessandro Baricco

24 mars 2021

A2 NEWS

Valbona Mazreku

“Durrësi qyteti më i ndotur i vendit”

(46) Ndotja e ajrit, studimi: Durrësi qyteti më i ndotur i vendit - YouTube



10 nëntor 2021

Euronews Albania

Valbona Mazreku

“Te dhënat mbi cilësinë e ajrit që thithim janë e drejtë themelore!”


11 nëntor 2021

Report TV

Valbona Mazreku

“Ja cilat janë zonat më të ndotura në Tiranë”

Raporti: Ja cilat janë zonat më të ndotura në Tiranë - Report-tv.al



10 janar 2022

RADIO TELEVISIONI SCAN

Valbona Mazreku

Emissioni EkoSkaner

“Bllokim i qëllimshëm, autoritetet s’matin ndotjen e ajrit”

<https://www.youtube.com/watch?v=kMËeLRNiLKs&t=1346s>

1 mars 2022

Mjedisi.al

Arion Sauku

Energjitë alternative në kohë krize!

Facebook

13 prill 2022



Syri Televizion

Valbona Mazreku, Arion Sauku

Varfëria energjitime në Shqipëri

(45) Varfëria energjitime në Shqipëri, flasin Valbona Mazreku dhe Arion Sauku, ekspertë mjedisi - YouTube



Vizion Plus
në emisionin 7pa5

Arion Sauku

- Dikur Rama i këndonte "zhurmës" së Tiranës e sot jemi qyteti me ndotjen akustike më të lartë

(45) 7pa5 - Dikur Rama i këndonte "zhurmës" së Tiranës e sot jemi qyteti me ndotjen akustike më të lartë - YouTube

dhjetor 2022

Scan TV

Shqetësimi për ndotjen e ajrit në Tiranë

Qytetet po betonizohen, cilësia e ajrit duhet të jetë prioritet i qeverisë.



<https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=Bc1PM05mtvo&feature=share&fbclid=IwAR0iunsY894hhlpbilHovVNV6farVzP6qJbMbSozR4W96YzVuEd41KhfZ60>

https://www.youtube.com/watch?v=W-h9gaDm_EY



Artikuj në median e shkruar
45 të rinj nga vendet e ballkanit pjesë e laboratorit të Energjisë

45 young people from the Balkan countries in the Albanian Energy Lab - EUKI Platforma scan, Dhjetor 2022

Milieukontakt Shqipëri – Ndotja e ajrit në Tiranë, tej normave.

Rezultatet nga matjet periodike për cilësinë e ajrit në 400 stacione në Tiranë tregojnë se nivelet e ndotësve janë tej normave të lejuara. Matjet janë kryer nga një konsorcium organizatash gjatë muajit Shtator 2022, duke nxjerrë një pah një panoramë që nuk është bërë publike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, që është institucioni përgjegjës në këtë drejtim.

Ndotja e ajrit në Tiranë, tej normave – Monitorimi i organizatave, në 400 stacione. Agjenica Kombëtare e Mjedisit s'jep asnjë të dhënë – SCAN TV



BOTIME

“Analizat legislative, institucionale dhe praktike të situatës aktuale mbi menaxhimin e mbetjeve”

nëntor 2021

Dokumenti jep një pasqyrë të gjendjes aktuale të infrastrukturës së grumbullimit të mbetjeve plastike nga familjet (të dhënat e disponueshme të marra nga gjenerimi i mbeturinave komunale/bashkiake, vendgrumbullimet, riciklimi, skemat e klasifikimit dhe infrastruktura në vend, shërbimi i ofruar për qytetarët dhe bizneset); gjendjes aktuale të infrastrukturës së grumbullimit të mbetjeve plastike nga kompanitë/industrinë; kapacitetet për riciklimin e mbetjeve plastike në vend dhe praktikat mjedisore të menaxhimit të mirë; tregut për materialet e ricikluara brenda vendit; kapaciteteve për rikuperimin e energjisë së plastikës; për nivelin e pastërtisë në vendgrumbullimet e mbetjeve; kërkesat ligjore në vend. Dokumenti përshkruan gjithashtu kërkesat ligjore në nivel kombëtar dhe vendor për aktorë të ndryshëm lidhur me mbetjet plastike, menaxhimin e tyre dhe lëvizjen ndërkufitare.



Analizat legislative, institucionale dhe praktike të situatës aktuale mbi menaxhimin e mbetjeve

Tiranë, Nëntor 2021



PROKURIMI PUBLIK I GJELBER PER BASHKITE



“Prokurim i gjelbër për bashkitë”

qershor 2022

Prokurimi publik i gjelbër (PPGJ) është një mjet vullnetar i politikës mjedisore që mund të mbështesë qasjen miqësore me mjedisin për aktivitete të përditshme si: ofrimi i pijeve freskuese, evente të hapura, ngjarje sociale, trajnime, etj. Prokurimi publik i gjelbër gjen zbatim duke përfshirë kriteret specifike në kërkesat e prokurimit si në specifikimin teknik të objektit të prokurimit, ashtu dhe në kriteret e vlerësimit të ofertave. Të dyja metodat synojnë të marrin një produkt që është më miqësor ndaj mjedisit sesa produktet konvencionale. Kriteret e gjelbra mund të zbatohen në të gjitha fushat e aktiviteteve të ofruara nga pushteti vendor.

<http://milieukontakt.org/wp-content/uploads/2022/08/brochure-shqip.pdf>

“Analiza e ndotjes akustike në zonat bregdetare – Bashkia Himarë”

Ky raport ka si qëllim analizimin dhe interpretimin e informacionit mbi perceptimin e komuniteteve lokale mbi nivelin e zhurmave në zonat bregdetare në Bashkinë Himarë. Ndotja akustike është kthyer në një problem të madh në qytetet e mbarë botës. Këtij fenomeni nuk mund t'i shpëtojnë dot as qytetet tona.

<http://milieukontakt.org/wp-content/uploads/2022/05/Ndotja-akustike-ne-zonat-bregdetare-Bashkia-Himare.pdf>



“Analiza e ndotjes akustike në zonat bregdetare – Bashkia Vlorë”

Ky studim është realizur duke marrë në shqyrtim mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të siguruar nga plotësimi i 700 pyetësorëve në bashkinë Vlorë. Pyetësori është ndërtuar në formë të tillë që të mbledh të dhëna për; shpeshësinë e zhurmës dhe intervalet kohore, në të cilat zhurma është më shumë e pranishme; efektet që jep në shëndetin e njeriut prania e zhurmës; nësa ka pasur ndryshim të nivelit të zhurmës vitet e fundit; burimet kryesore të zhurmës; a ka ose jo rregullore për zhurmat bashkia ku jetojnë; sa të informuar janë banorët se cilët janë institucionet përgjegjëse për marrjen e masave për minimizimin e zhurmës dhe nëse kanë ose jo besim te këto institucione; sa e ndjeshme është media kundrejt këtij fenomeni; cilat janë zonat me të ekspozuara ndaj zhurmës gjatë sezonit të verës dhe pjesës tjetër të vitit.

<http://milieukontakt.org/wp-content/uploads/2022/05/Ndotja-akustike-ne-zonat-bregdetare-Bashkia-Vlore.pdf>



“Parandalojme së bashku ndotjen detare”

Është një borshurë e cila do të përdoret nga nxënësit dhe mësuesit në qarkun e Lezhës si dhe kolegët e tyre; për t'i ndihmuar që të kuptojnë ndikimin e plastikës në mjedis, duke nxitur sjelljen miqësore me mjedisin. Mësuesit do të gjejnë informacione ndihmëse mbi ndotjen dhe mbetjet detare, për të zhvilluar orë mësimore me nxënësit e tyre. Do të gjejnë gjithashtu këshilla dhe fakte interesante rreth ndotjes detare nga vendi dhe rajoni. Nxënësit do të mund të praktikojnë e fitojnë ide për aktivitete të ndryshme argëtuese dhe ndërgjegjësuese mbi parandalimin apo reduktimin e ndotjes detare.



“Objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e mjedisit”

Axhenda e vitit 2030 synon një botë pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, një mjedis të qëndrueshëm duke menaxhuar sistemet e ujësjellës-kanalizimeve, sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit, sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë, marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë, ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

“Studim lidhur me Komunitetet e Energjisë për Qytetarët në Shqipëri”

Në vitin 2018, Paketa e Energjisë së Pastër të Komisionit Evropian njohu të drejtën e komuniteteve lokale dhe qytetarëve për të luajtur një rol aktiv në sektorin e energjisë duke i përcaktuar si “Komunitete të Energjisë”, të cilët më pas janë specifikuar në dy ligje të veçanta të Paketës së Energjisë së Pastër. Direktiva e rishikuar e Energjisë së Rinovueshme (BE) 2018/2001 përcakton kornizën për “Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme” që mbulon energjinë e rinovueshme. Direktiva e rishikuar e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike (BE) 2019/944 përcakton rolet dhe përgjegjësitë e reja për “Komunitetet e Energjisë për Qytetarët” në sistemin e energjisë që mbulon të gjitha llojet e energjisë elektrike.



"Raport përmbledhës i ecurisë 2015-2020".

Mund të njiheni me nismat dhe projektet e relizuara nga MiA përgjatë pesëvjeçari (2015-2020) në fushat prioritare të

mjedisit si:

- A. Zhvillimi i Qëndrueshëm
- B. Integrimi në BE
- C. Qeverisje demokratike dhe ndërtim kapacitetesh
- D. Mjedisi dhe shëndeti
- E. Politika dhe legjislacioni mjedisor

“Udhëzues për përmirësimin e mirëqenies energjitike në shtëpinë tuaj”

Udhëzuesi do t'ju tregojë nëse keni vështirësi në pagesën e faturave të energjisë apo nëse ju ndjeni të ftohtin dhe të nxehtin në shtëpinë tuaj; por ju nuk jeni i vetëm në këtë situatë! Shumë njerëz e kalojnë këtë. Eksperienca e tyre, si dhe njohuritë e ekspertëve në fusha të ndryshme, përforcon këtë përmbledhje sygjerimesh dhe këshillash për përmirësimin e mirëqenies së shëndetit dhe të shtëpisë suaj.



Studimi “Buxhetimi i Gjelbër në Shqipëri”

Studimi vjen për herë të parë, edhe pse nuk ka një kuadër rregullator detyrues për zbatimin e tij. Buxhetimi i gjelbër është një formë e buxhetit prioritar, sikundër politika të reja shfaqen për politikbërësit dhe qeveritë vendosin qasje buxhetore novatore për të ndihmuar arritjen e këtyre objektivave. Në dekadat e fundit shtetet anëtare të BE-së kanë nisur të integrojnë politika për të adresuar sfidat mjedisore, përfshirë dhe politika buxhetore. Mirëpo pak nga këto vende kanë praktika të buxhetimit të gjelbër dhe ato janë tepër heterogjene. Studimi merr në shqyrtim kuadrin specifik kombëtar për të konfirmuar përputhshmërinë dhe koherencën me buxhetimin e gjelbër dhe angazhimet globale të lidhura me veprimin ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe vlerësimin e mjeteve ekzistuese për të kryer buxhetimin e gjelbër në Shqipëri. Në kontekstin e Shqipërisë, zbatimi i aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme për mjedisin është një prioritet i konfirmuar i lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian

VIZIONI I SË ARDHMES

Milieukontakt Shqipëri ndërmerr partneritete për të përmirësuar cilësinë e jetës, duke rritur pjesëmarrjen e njerëzve dhe shoqërive për një zhvillim të qëndrueshëm.

Milieukontakt bashkëpunon me partnerë (ndër)kombëtarë, sepse problemet mjedisore nuk kanë kufi. Shumë nga sfidat aktuale mjedisore janë mbarë botërore. Në nivel lokal njerëzit mund të mbështeten dhe të mësojnë nga përvojat e të tjerëve që punojnë me të njëjtat probleme në pjesë të tjera të botës. Milieukontakt lidh njerëzit, organizatat dhe rrjetet që merren me të njëjtat sfida dhe duan të bashkëpunojnë drejt rritjes së pjesëmarrjes qytetare në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Milieukontakt do të sigurojë njerëzit me mjetet dhe aftësitë për të përdorur mundësitë për pjesëmarrje, duke përfshirë trajnimin, këshillimin (ligjor) dhe asistimin. Proceset vendimmarrëse me pjesëmarrje janë thelbësore në këto partneritete. Milieukontakt fokusohet në ofrimin e mjeteve për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe zbatimin e projektit.

Ngritja e kapaciteteve Të jesh një mjedisor do të thotë të mësosh gjatë gjithë jetës dhe kjo e bën çështjen interesante dhe sfiduese! Për të qenë efektive, një lëvizje mjedisore kërkon një sërë aftësish që nuk mësohen lehtësisht në shkollë apo në universitet. Mjedisorët duhet të dinë për gamën e gjerë të çështjeve të mbuluara nga 'mjedisi'. Energjia, ndryshimet klimatike, mbeturinat, menaxhimi i ujit, kanalizimet, kimikatet dhe bujqësia janë disa nga çështjet. Mjedisori duhet gjithashtu të jetë në dijeni të zhvillimeve në qarqet shkencore dhe politike. Sot, çdo gjë lidhet me ndryshimin e klimës dhe atë që do ose nuk do të sjellë në të ardhmen. Ndaj njohuritë duhen përditësuar për të qenë një partner me qeveritë dhe palët e tjera të interesuara. Përveç njohurive mbi çështjet globale, duhet ditur se çfarë po ndodh në vendin, rajonin, qytetin apo fshatin për veprime më efektive. Kjo do të thotë që mjedisorët vazhdimisht mësojnë dhe përshtatin njohuritë shkencore me punën e tyre të përditshme. Ata duhet t'i përkthejnë këto njohuri në politikë dhe veprime. Aftësitë e komunikimit janë thelbësore, siç janë ekspertiza ligjore dhe aftësitë negociuese. Ndonjëherë duhet t'i drejtohem gjykatës ose të negociojmë nëse, nuk ka ndonjë mënyrë tjetër. Ka shumë fusha të tjera në të cilat mjedisorët duhet të përgatiten për t'u bërë efektive; p.sh si të jenë administrator të mirë, projektues, drejtues projekti, profesionist dhe të dinë se si të mundësojnë financimin e të gjitha punëve.

Përfshirja e qytetarëve Nuk ka pothuajse asnjë fushë përveç politikës mjedisore në të cilën përfshirja e qytetarëve është kaq e rëndësishme për suksesin e politikës qeveritare. Shumë çështje politike kanë të bëjnë me çështje të tilla si: sjellja, diferencimi i mbetjeve, lëvizshmëria, ruajtja e energjisë dhe mbrojtja e natyrës. Këto janë të gjitha fusha politike që mund të mbështeten nga instrumentet teknike dhe ligjore, por që në fund gjithmonë bazohen në mbështetjen e qytetarëve dhe në ndryshimin e qëndrimit dhe sjelljes. Milieukontakt zhvilloi metodologji për të frymëzuar qytetarët për të zhvilluar "Axhendën e Gjelbër" të tyre dhe, jo vetëm për t'u përfshirë në hartimin e politikave, por edhe për të qenë proaktive.

Zgjidhja e problemeve mjedisore Gjithçka që ka të bëjë me zhvillimin e një shoqërie të qëndrueshme. Për të arritur qëndrueshmërinë, duhet të zgjidhen problemet ekzistuese mjedisore dhe të zhvillohen koncepte (djep për djep), metoda (riciklimi) dhe mjete (pajisje me energji të ulët), për të parandaluar probleme të reja. Ndërtimi i kapaciteteve dhe përfshirja qytetare pa punuar në drejtim të zgjidhjes së problemeve nuk ka vlerë në arritjen e qëllimit.

STRATEGJIA

Milieukontakt nuk mund të arrijë e vetme misionin e saj. Ne jemi pjesë e rrjeteve formale dhe joformale të njerëzve dhe organizatave që punojnë drejt përmbushjes së misionit tonë. Aftësia për të bashkëpunuar me organizatat komunitare dhe me donatorët, qeverinë dhe biznesin ndërkombëtar, është një nga pikat e forta të Milieukontakt.

Ne krijojmë aleanca strategjike dhe partneritete me organizatat e shoqërisë civile, autoritetet, bizneset dhe institucionet ndërkombëtare aktive për zhvillimin e qëndrueshëm ose çështje të tjera që lidhen me këtë temë si gjinia, shëndetësia dhe arsimi.


Ne zhvillojmë, përdorim dhe lehtësojmë metodat e pjesëmarrjes, shkëmbimin e informacionit, analizën dhe veprimtarinë midis palëve të interesuara dhe lidhim këtë qasje me zgjidhje praktike, me kosto efektive dhe të qëndrueshme për sfidat mjedisore.

Ne bashkëpunojmë me shkencëtarë (social) dhe institucione kërkimore për të hulumtuar, analizuar dhe zhvilluar më tej qasjen e Milieukontakt dhe metodat e punës.


Ne do të zbatojmë në punën tonë të përditshme kodin tonë të sjelljes me rregullat për sjellje për të luftuar korrupsionin në projekte dhe partneritete.

TRANSPARENCA DHE PASQYRAT FINANCIARE


Grafiku i parë tregon të ardhurat financiare për vitin 2021- 2022. Këto të ardhura kanë ardhur në rritje me 10%.




Grafiku i tretë tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2021. Sipas shpenzimeve të kryera rezultojnë se 35% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, ndërsa pjesa e mbetur ndahet në 3% për shpenzime administrative zyre, 22% ekspertizë, 3% shpenzime publikime, 37% për paga dhe sigurime.



Grafiku i dytë tregon fondet sipas burimeve të financimeve, ku peshën më madhe e zënë fondet nga Bashkimi Evropian (59-68%) dhe më pas ato nga burime nga projekte me organizata të huaja (20-27%).



Grafiku i katërt tregon shpërndarjen e buxhetit për vitin 2022. Sipas shpenzimeve të kryera rezultojnë se 28% e fondit shkon për zbatimin e projekteve, 17% për shërbime publikime, 2% për shpenzime administrative zyre, 24% për paga dhe sigurime, 29% ekspertizë.



MILIEUKONTAKT
ALBANIA
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY



www.milieukontakt.org
office@milieukontakt.org